



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.95/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada - Glllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor, Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterit në vende publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega në Prishtinë, dhe koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Pejë, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 3,900.00 (tremij e nëntqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 06.06.2017, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 05.06.2017, rreth orës 21:00 në sheshin "Mbretëresha Teutë" në Pejë, aktivistja Arta Berisha ka vërejtur një poster të kandidatit për kryeministër të Qeverisë së Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA i vendosur nëpër drunjë, pra në hapsira publik Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b i Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 të KQZ-së, neni 3.4 i Rregullës Zgjedhore nr.13/2014, vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë publike përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidaët dhe mbështetësit e tyre . Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një fotografi nga vendi ku ka ndodhur shkelja e Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët.

Në përgjigjen në ankesë i datës 07.06.2017 koalicioni PDK-AAK-NISMA, nuk e ka pranuar shkeljen e pretenduar në ankesë duke arsyetuar se vendosja e posterit të kandidatit Ramush Haradinaj për kryeministër të Republikës së Kosovës në sheshin "Mbretëresha Teutë" në Pejë, pra të ngjitura nëpër drunjë nuk është vendosur nga strukturat e AAK-së dhe se i njëjti veprim i vendosjes së posterit mund të jetë bërë nga qytetarë apo individ të pa njohur – të pa identifikuar. Koalicioni PDK-AAK-NISMA e ka vendosur posterin e kandidatit për kryeministër dhe se koalicioni PDK-AAK-NISMA pas marrjes së ankesës nga ana e PZAP-së kanë ndërmarr masat përmirësuese, duke i njoftuar strukturat menagjuese të fushatës, për evitimin e shkeljes sipas ankesës. PZAP-it i kanë kërkuar që të marrin parasysh veprimet e koalicionit konform dispozitave të parapara sipas nenit 3 alinea 3.3,3.4 dhe 3,6 i Rregullës

Zgjedhore nr.11/2013, për thirrjen dhe lajmërimin e të gjitha strukturave dhe mbështetësve që ta rrespektojnë ligjin dhe rregulloren e Kodit të Mirësjelljes.. Përgjigjes në ankesë si provë për të dëshmuar pretendimet e tyre i kanë bashkangjitur pesë foto nga vendi ku është larguar posteri

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoj shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 i LZP-së, gjeti se :

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruar si provë e cilat gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se, posteri i kandidatit për kryeministër të Republikës së Kosovës Ramush Haradinaj nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Pejë, është vendosur në pemë në sheshin "Mbretëresha Teutë", pra në hapsira publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) i LZP-së e cila përcakton " *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*"

Duke u nisur nga gjendja e theksuar faktike, Paneli konstaton se nga prova e ofruar shihet qartë se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33 pika (b) i Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, pasi që posteri i kandidatit për kryeministër nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, është i ngjitur me lëpak në pemë pra në hapsirë publike. Të cilën shkelje nuk e ka pranuar koalicioni PDK-AAK-NISMA, sipas përgjigjes në ankesë i datës 07.06.2017.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase koalicioni PDK-AAK-NISMA kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftu me rregullat zgjedhore, se shkelja nga ana e tyre është përsëritur vazhdimisht gjatë këtij procesi zgjedhor dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatit për kryeministër nga ky koalicion është i kapur me ngjic në pemë pra në hapsira publike . Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e morri edhe faktin që koalicionit në fjalë ia dha mundësin për tu përgjigjur, ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes, ashtu që kanë tërhequr posterin në vendin e palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.95/2017 më datën 07.06.2017.

Kryesuesi i Panelit

Zyhdi Haziri

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.

